



Ku mund të vaksinoheni?

Ju mund të vaksinoheni:

- Në një **qendër vaksinimi**
 800 009 110  vw.santé.fr
- Te **mjekët** tuaj, në **farmacinë** tuaj lokale ose në **qendrën tuaj të kujdesit shëndetësor**
- Në **vendin tuaj të punës** nëse punoni në një institucion të kujdesit shëndetësor

A keni pyetje?

Pyesni një profesionist të kujdesit shëndetësor, një punonjës social, n *mairie*-në tuaj (bashkinë e qytetit)



ose në



Për t'u vaksinuar, telefononi në:


0 800 009 110

(pa pagesë)

ose në

Santé.fr

Vaksinat Covid – Informacion i nevojshëm



Marrja e vaksinës: ka të bëjë vetëm me mbrojtjen tuaj

Falë vaksinave, trupi juaj mëson të njohë Covid dhe të mbrojë veten.


Vaksinat Covid janë shumë efektive në mbrojtjen ndaj formave të rënda dhe fatale të Covid-19.

Vaksinat janë falas për këdo.




Vaksinat Covid – Pyetjet e mia

Nëse kam një gjendje shëndetësore (si p.sh. diabet, kancer ose një gjendje të pazakontë), a mund të vaksinohem?



Nëse keni një gjendje shëndetësore, duhet të vaksinoheni sepse ju mund të infektoheni lehtësisht nga një formë e rëndë dhe fatale e Covid-19. Vakcina do ju ndihmojë ta luftoni virusin.

Edhe nëse e keni kaluar Covid-19, ju duhet të vaksinoheni. Ju mund ta bëni këtë midis muajit të tretë dhe të gjashtë pas infektimit, me vetëm një dozë (në vend të dy dozave).



Nëse e kam kaluar Covid-19, a duhet të vaksinohem?

Nëse jam vaksinuar, a mund të kthehem në gjendje normale dhe të heq maskën?



Jo Edhe nëse jeni vaksinuar, duhet të vazhdoni të mbani maskën dhe të merrni masa mbrojtëse derisa e gjithë popullata të jetë vaksinuar.

Nëse jam vaksinuar, a mund të udhëtoj më lehtësisht?



Jo

Edhe nëse jeni vaksinuar, duhet të bëni një analizë PCR-je 72 orë përpara udhëtimit, derisa e gjithë popullata të jetë vaksinuar. Kjo analizë është falas dhe nuk shqërohet me dhimbje. Ju duhet të kontrolloni rregullat e secilit vend përpara se të udhëtoni.

